

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
Nr. 1014 Rep.  
Nr. 468 Kol.



### AKT THEMELIMI & STATUT

#### I SHOQERISE « PRAETORIAN » shpk, TIRANE

Sot me date 26 Qershor 2019(dymije e nentembedhjete), para meje Noter Muli Y. MALLKUÇI, Anetar i Dhomës Notereve Tirane, me Zyre ne Rr. "Vaso Pasha", Pall. 13/1, u paraqiten personalisht:

**Z. Giancarlo Francesco DIMAURO**, lindur me 17.11.1955 ne San Severio (FG), Itali dhe banues ne Itali, me zotesi te plete juridike per te vepruar, identifikuar me pasaporte italiane nr. ZA2641147.

**Zj. Carla SALA**, lindur me 02.03.1957 ne Casteggio, Itali dhe banuese ne Itali, me zotesi te plete juridike per te vepruar, identifikuar me pasaporte italiane nr. YA1272923

**Z. Shpetim MEMETAJ**, lindur me 04.09.1959 ne Tirane, banues ne Tirane, me zotesi te plete juridike per te vepruar, identifikuar me leternjoftim nr. personal F90904111P.

Te cilet me cilesine e "Ortakëve Themelues", me kerkuan redaktimin e ketij Akti Themelimi & Statut, nepermjet te cilit deklaruan se, me vullnet te lire, te plete e te singerte dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikës se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne Ligjin nr. 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne Ligjin Nr. 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me per gjegjesi te kufizuar, "**PRAETORIAN**" shpk, Tirane.

Neni 1

Krijimi

Shoqeria "**PRAETORIAN**" shpk, Tirane, eshte person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqeri me per gjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jetë regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqeria "PRAETORIAN" shpk, Tirane, eshte një e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaket që përballojne humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3  
Selia

Shoqeria e ka seline ne: Rruga "Llambi Bonata", Pallati 48, Shkalla 1, Ap.1, Tirane.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakeve.

Adresa e –mail: shpetim.m hotmail.it

Neni 4  
Objekti i veprimtarise

Shoqeria ka si objekt:

- zotërimi i aksioneve, jo kundrejt publikut, në shoqëria ose kompani të tjera të çdo lloji dhe me çfarëdo objekti, italiane ose të huaje;
- planifikimin, organizimin dhe kontrollin strategjik dhe operacional të shoqërive në të cilat zotëron aksione ;
- sigurimin e shërbimeve financiare, tregtare, te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, administrative, kontabiliteti dhe shërbime teknike në favor të shoqërive që zotëron aksione.

Për qëllimin e vetëm të përbushjes së objektit të shoqërisë dhe jo ndaj publikut, shoqëria mund të kryejë edhe operacione industriale, tregtare, financiare, te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme të cilat konsiderohen të nevojshme ose të dobishme.

Për këtë qëllim, shoqëria mund të japë hua herë pas here për shoqëritë që zotëron aksione, si dhe te lëshojë, gjithmonë herë pas here, garanci në interesin e tyre ekskluziv dhe në favor të bankave ose ndërmjetësve financiarë të regjistruar në listën e veçantë.

Përjashtohen nga aktiviteti i shoqërisë :

- dhënia e garancive palëve të treta;
- mbledhja e kursimeve nga publiku dhe blerja dhe shitja me anë të ofertës publike të mjeteve financiare të disiplinuara me Ligj.
- ushtrimi në lidhje me publikun i aktiviteteve te zotërimit të aksioneve, dhënien e kredive në çdo formë, kryerja e shërbimeve me pagese dhe ndërmjetësimit në këmbime dhe çdo aktivitet tjetër ne përputhje me Ligjet ne fuqi.

*[Handwritten signatures]*

Neni 5  
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit(QKB).

Neni 6  
Kapitali themeltar

**Kapitali themeltar** i shoqerise eshte 10.000Lekë (dhjete mijë)dhe eshte i ndare në 3 (tre) kuota, vlera nominale e sejçiles eshte si me poshtë.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe shlyer tërësisht ne te holla nga ortaket e shoqerise, Z. **Giancarlo Francesco DIMAURO**, i cili zoteron 1 (nje) kuote, me vlerë te per gjitheshme 8.000Leke (tetemije), qe perbejne 80% te kapitalit themeltar te shoqerise, Zj: **Carla SALA**, e cila zoteron 1 (nje) kuote, me vlerë te per gjitheshme 1.000Leke (nje mijë), qe perbejne 10% te kapitalit themeltar te shoqerise dhe Z. **Shpetim MEMETAJ**, i cili zoteron 1 (nje) kuote, me vlerë te per gjitheshme 1.000Leke (nje mijë), qe perbejne 10% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaket per gjigjen per humjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7  
Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali mund të zmadhohet një ose më shumë herë, me anë të vendimit te Asamblesë së jashtëzakonshme të aksionerëve, nëpërmjet emetimit të aksioneve të zakonshme, ose me të drejta të ndryshme, në pajtim me ligjin ose duke rritur vlerën nominale të aksioneve.

Neni 8  
E drejta e parablerjes

Pagesat për aksionet kërkohen nga Ortaket, në përputhje me ligjin dhe në mënyrat e duhura.

Në rast të zmadhimit të kapitalit ortaket, kuotat duhet të ofrohen në opsjon për ortaket në proporcione kuotat e zotëruara nga secili.

Oferta e opsjoneve duhet të dorëzohet në Regjistrin e Shoqërive Tregtare dhe ushtrimi i së drejtës së parablerjes duhet të ushtrohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve

nga publikimi i ofertës, përveç nëse afati më te gjate që përcaktohet nga Asambleja e Ortakeve.

Kur interesi i shoqërisë e kërkon, e drejta mund të përjashtohet ose të kufizohet me vendimin përmadhimin e kapitalit, të miratuar nga shumica e pjesëmarrësve të cilët në çdo rast përfaqësojnë më shumë se 50 (pesëdhjetë) përqind të kapitalit te ortakeve, edhe nëse vendimi është marrë në asamblenë e thirrur menjëherë pas së parës.

#### Neni 9

#### Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm duke respektuar se pari te drejten e parablerjes nga oratku tjeter.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

#### Neni 10

#### Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakeve brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit finanziar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratorët,

Ajo mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person.

#### Neni 11

#### Zvogëlimi i kapitalit aksionar

Asambleja e aksionerëve mund të vendose mbi reduktimin e kapitalit aksioner, në përputhje me dispozitat e ligjit, edhe nëpërmjet caktimit ortakeve te vetëm ose grupe ortakesh, aktivitete të caktuara ose aksione ose kuota në shoqëri të tjera në të cilat shoqëria zotëron aksione.

#### Neni 12

#### Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga Asambleja e Ortakeve.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 13  
Obligacionet

Shoqëria mund të lëshojë obligacione bartëse ose nominale në përputhje me dispozitat e ligjit.

Neni 14  
Administrimi

**Administrator** i shoqerise do te jetë **Z. Giancarlo Francesco DIMAURO**, per nje afat prej 5 vjetesh.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asambleja e Ortakeve te shoqerise.

Neni 15  
Financimet

Ortaket do tē jenë nē gjendje tē kryejnë, me kërkesë tē organit administrativ, pagesa ne llogarinë e kapitalit dhe financime me interes dhe pa interes, nē proporcion ose jo me aksionet e tyre përkatëse, nē përputhje me rregulloret nē fuqi me referencë tē veçantë dhe brenda kufijve tē atyre që qeverisin mbledhjen e kursimeve tē publikut.

Neni 16  
Kompetencat

Administratori ka tē gjitha kompetencat pēr tē vepruar nē marrëdhënie me tē tretët nē emër tē shoqërisë, nē tē gjitha rr Ethanat me pērjashtim tē kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakut te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë nē marrëdhëni me tē tretët nē pērmjet akteve që janë nē përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr pērsipēr pasojat ndaj tē tretëve kur ajo provon se tē tretët e dinin që akti I administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur tē tretët nuk mund ta injoronin këtë akt nē rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, tē cilat rrjedhin nga ky nen, duhet tē respektohen nga tē tretët.

Administratorit ose ortakut që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet tē kontraktojnë nē çfarëdolloj forme qoftë, tē marrin hua te shoqëria, tē japin pëlqimin nē emër tē saj, pēr paradhënie si dhe tē bëhen dorëzënës apo tē garantojnë nē emër tē saj angazhimet ndaj tē tretëve. Në rast tē kundërt kontrata është e pavlefshme.

*tarle fab* *Alb* *wulf*

Neni 17  
Pergjegjesite

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja e ortakeve që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale pasojat përkatëse.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, sejciili nga ortaket kane të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit Ortaku ka të drejtë të ndjeke në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Ortaku që nuk eshte administrator, ka të drejtë në çdo kohë të informohet personalisht për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentet e shoqërisë.

Neni 18  
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

Neni 19  
Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese se Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblese se Ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 20  
Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e Asamblese se Ortakeve.

*[Handwritten signatures]*

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit reportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe Asambleja se Ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

#### Neni 21

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga ortaku i vetem, i cili jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibiliteten e fondevi ligjore sipas nevojave të zhvillimit të metejshem të shoquerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecante etj.

#### Neni 22

Të ardhurat neto ( Dividenti ) qe mbeten pas vecimit të fondevi ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi, ortakeve të shoquerise.

#### Neni 23

Shperndarja ose prishja e shoquerise mund të behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkaku, edhe para plotesimit të afatit per të cilin eshte krijuar sic mund të jene : Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.

Ne nje nga menyrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"

c) Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoquerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqli ne likuidim e siper ".

#### Neni 24

#### Bashkimi dhe ndarja

Shoqëria, me anë të bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon.

Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërise të tjera ekzistuese ose disa shoqërise të reja.

Ortaket e shoqërise, që bën kalimin e trashëgimisë së saj në kuadrin e



operacioneve të përmendura me lart përfiton pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqërítë përfituese dhe sipas rastit një kompensim me para, vlera e të cilit nuk mund të kalojë 10 për qind të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhëna.

Operacionet e përmendura me lart mund të realizohen ndërmjet shoqërive të formave të ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqërise që zhduket, dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj t e shoqërítë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërive që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve të shoqërive përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

#### Neni 25

Afati i emerimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne QKB.

#### Neni 26+

Likuidatori eshte i detyruar qe të jetë i vemendshem dhe korekt, si per realizimin e të drejtave per subjektet ndaj të cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve të vecante apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.

#### Neni 27

##### Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjispcionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit per QKB, Kodit Civil, Ligji per Shoqerite Tregtare dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

#### Neni 28

##### Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptare.



Neni 29  
Regjistrimi

Rregjistrimin e shoqerise prane QKB, do ta beje Zj. Ensuida Gjoni, me ID Nr.Personal J05812085P.

Neni 30  
Dispozita perfundimtare


Ky Akt Notarial, u redaktua ne 3 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare “ **PRAETORIAN** ” shpk, Tirane, ne prani te perkthyeses ne gjuhen Italiane Znj. Ensuida Gjoni, nenshkruhet rregullisht para meje dhe une noteri e vertetoj sipas ligjit.

ORTAKET


Giancarlo Francesco DIMAURO



Carla SALA

  
CARLA SALA

Shpetim MEMETAJ




Perktheu:  
Ensuida Gjoni

Ensuida Gjoni



NOTE R

Muli Y. MALLKUÇI

  
Muli Y. MALLKUÇI